Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr. 293/19
Datë/Datum 17.07.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr. 293/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042,i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje: z.Nuhi Paçarizi– Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "MEDIATECH & PRINT" SH.P.K – Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "INFINITT"SH.P.K.– Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me letër Termike (Rollne) për arka fiskale", me numër të prokurimit: TU-19-3128-1-3-6, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –N.P.K. "TRAFIKU URBAN"SH.A,më datën 04.07.2019 mori këtë:

V E N D I M

I.<u>REFUZOHET</u>, si e pa bazuar ankesa e operatorit ekonomik"MEDIATECH&PRINT"SH.P.K– Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimitme titull:"Furnizim me letër Termike (Rollne) për arka fiskale", me numër të prokurimit: TU-19-3128-1-3-6, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –N.P.K. "TRAFIKU URBAN"SH.A.

II.<u>VËRTETOHET</u>,njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin të prokurimitme titull"Furnizim me letër Termike (Rollne) për arka fiskale", me numër të prokurimit: TU-19-3128-1-3-6, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – N.P.K. "TRAFIKU URBAN"SH.A.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV.Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V.Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues"MEDIATECH & PRINT"SH.P.K– Prishtinë,refuzohet si e bazuar, i bëhet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë me dt:14.05.2019
Hapja e ofertave është bërë me dt:20.05.2019
Njoftimi me letër standarde për tenderues të eliminuar/pasuksesshëm dt: 23.05.2019
Vendimi i Autoritetit Kontraktues dt: 23.05.2019
Kërkesë për rishqyrtimdt: 28.05.2019
Autoriteti Kontraktues me datën 30.05.2019ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim si e pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues "MEDIATECH & PRINT"SH.P.K– Prishtinë,si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me10.06.2019me nr. 293/19,kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull"Furnizim me letër Termike (Rollne) për arka fiskale", me numër të prokurimit: TU-19-3128-1-3-6, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – N.P.K. "TRAFIKU URBAN"SH.A,duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin6, 7,28,dhe 59të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit,konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 11.06.2019ka autorizuar ekspertin shqyrtuesprofesional tëprokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues në raportin e dt:19.06.2019, konstaton dhe sqaron si në vijim:
Arsyeje e eliminimit të OE "MEDIATECH & PRINT" SHPK, sipas autoritetit kontraktues është citat: "Në ofertën tuaj nuk keni plotësuar kërkesat mbi mundësit teknike dhe ose profesionale, saktësisht nuk

keni ofruar e Autorizimit nga punëdhënësi ose distributori të autorizuar për shitjen e letrës termike (rollneve), si dhe mostrat e ofruara nuk plotësojnë kërkesat e AK-Trafiku Urban".

Eksperti shqyrtues konstaton se në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit është kërkuar: "Operatori ekonomik duhet në ofertën e tije të prezantoj kopjen e Autorizimit nga Prodhuesi ose distributori të autorizuar për shitjen e letrës termike (rollneve). Nga fituesi relevant do të kërkohet sjellja në origjinal e autorizimit të prezantuar para shpalljes se vendimit të AK".

Andaj pas analizimit dhe sqarimit të dosjes së tenderit si dhe pretendimeve ankimore, eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues ***"MEDIATECH & PRINT" SHPK,*** *nuk e ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, pra nuk ka ofruar* ***autorizim*** *nga* ***prodhuesi*** *e as nga* ***distributori i autorizuar*** *për shitjen e letrës termike (rollnev).*

Sa i përket pretendimit të OE ankues "MEDIATECH & PRINT" SHPK, ku pretendon se AK-së, konform nenit 39.8 të RrUOPP-së, ka qen i obliguar të kërkoj sqarime shtesë, eksperti shqyrtues sqaron se tek neni 39.8 i RrUOPP-së, konkretisht tek pjesa tabelore sqarohet qartë.

Është kërkuar autorizimi origjinal por është dorëzuar autorizimi i skanuar	Mund te kërkohen informata sqaruese	66

Eksperti shqyrtues se OE ankues ndër të tjera pretendon se në këtë aktivitet të prokurimit kemi tre 3 autorizime të njëjta, duke pretenduar se autorizim jepet vetëm për një distributor dhe vetëm një OE mundet të konkurroj me atë autorizim edhe ky fakt është shumë kontradiktor, pasi edhe me dispozita ligjore vetëm një autorizues e ka autorizimin nga distributori.

Eksperti shqyrtues sqaron se operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit NTP "VLORA", "INFINITT" SHPK dhe NTG "BLENDI", e kanë autorizimin nga NT "FIRST POINT", përfaqësuar nga Astrit Martinaj – drejtor, andaj askund as një dispozitë e LPP-së dhe RrUOPP-së, nuk e ndalojnë dhënien e autorizimit nga Distributori dy e më shumë OE.

Operatori ekonomik ankues "MEDIATECH & PRINT" SHPK,deklaron: Po ashtu qe kemi vërejtur se kompania e shpallur fituese në këtë aktivitet të prokurimit është me pronar e drejtor të njëjtë sikur OE i renditur i pari në procesverbalin e hapjes.

Eksperti shqyrtues sqaron se pas analizimit të pretendimit ankimor të OE ankues si dhe pas analizimit të ofertave të OE NTP "VLORA" dhe "INFINITT" SHPK, pronar dhe person i autorizuar në certifikatën e biznesit te OE NTP "VLORA", është z. Adnan Krasniqi, ndërsa tek certifikata e biznesit të OE "INFINITT" SHPK, pronar dhe person i autorizuar është znj. Selvie Krasniqi, pra këtu kemi të bëjmë me pronar të ndryshëm.

Eksperti shqyrtues konstaton se në dosjen e tenderit tek Aneksi 1 i dosjes (specifikimet teknike te detyrueshme) është kërkuar:

Letra termike (rollne) sasia 36000 copë me specifikime teknike:

- Garancioni i letrës pesë (5) vite (qëndrueshmëria e shënimeve në letër 5 vite);
- Gjatësia e rrollneve 58 mm gjatësia 30 m;
- Shtypja e logos në pjesën e pasme me ngjyrë;
- Dy (2) metrat e fundit rollnet duhet të jenë të vijëzuara me ngjyrë të kuqe si dëshmi se rrojllnja është shpenzua;
- Letra termike duhet të jetë sikur mostra më poshtë në foto e cila mund të shikohet edhe në formë fizike tek hapësirat e AK-së.

Vëmendje

1. Tenderuesi me ofertën të dorëzoj edhe një mostër para hapjes së ofertave për krahasim me mostrën e AK-së;
2. Tenderuesi duhet të ketë autorizimin nga prodhuesi ose të jetë distributor i autorizuar;

Andaj në bazë të vendimit mi refuzimin e kërkesës së shqyrtimit, OE ankues nuk e ka ofruar letrën termike (rollnen) me Shtypje të logos në pjesën e pasme me ngjyrë, dhe kjo mund të vërtetohet me mostrat të cilat është i obliguar ti ofroj AK-së, gjatë shqyrtimit kryesor.

Andaj duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pa bazuar (për arsyen që u cekura më lartë tek përgjigjet), dhe të mbetët në fuqi njoftimi mbi vendimin e Autoritetit kontraktues.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 19.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues sepajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 04.07.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues,përfaqësuesi i autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik ankues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertes shqyrtuese, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesja e OE-së znj. Gashi deklaroj:E kundërshtojmë mendimin e Eksperti Shqyrtues, e kontestojmë mendimin e ekspertit ne lidhje me mostrat pasi qe mostra i plotëson te gjitha kërkesat e dhe specifikimet teknike përveç se nuk kanë qenë me Logo te Autoritetit, letra është e njëjtë, cilësia është e njëjtë, te gjitha specifikat përveç qe nuk ka qenë e shtypur Logoja përndryshe te gjitha specifikimet teknike kanë qen te njëjta siç janë kërkuar ne DT, sa i përket Autorizimit është e vërtet qe nuk është bashkangjitur mirëpo, ne këtë AP kanë qenë 3 Autorizime të njëjta nga i njëjti distributor, dhe fituesi ka pas autorizimin e gjestin ashtu siç e kemi edhe ne.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi iAK-së z. Vitija deklarojë:N.P.K Trafiku Urban SH.A përkatësisht komisioni vlerësues i caktuar nga Kryeshefi Ekzekutiv ka bërë vlerësimin e ofertave në pajtim me Ligjin e prokurimit publik Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 dhe udhëzimin operativ për prokurim publik, përkatësisht Nenet 6,7,28,59,60 te LPP-se dhe nenin 39.8 dhe 41 të RRUOP gjatë vlerësimit të ofertave.

Komisioni nen mbikëqyrjen time si zyrtar përgjegjës ne zyrën e prokurimit ka vendosur për eliminimin e OE " MEDIATECH & PRINT " SH.P.K., me arsyetimin se ky OE nuk ka plotësuar kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale me saktësisht nuk ka ofruar kopjen e Autorizimit nga Prodhuesi ose distributori te autorizuar për shitjen e letrës termike (rollneve). Dhe mostra e ofruar nuk plotëson kërkesat e AK "Trafiku Urban", përkatësisht mostra e ofruara nuk është ne pajtim me kërkesat e parashtruara nga AK/njësia kërkuese si ne aneks 1 specifikimet teknike te detyrueshme.

- Për pretendimin ankimor lidhur me kursimin e buxhetit jemi te vetëdijshëm se neni 1 dhe 6 i LPP-se obligon AK qe te shfrytëzojë fondet ne mënyrë sa me efikase dhe ekonomike mirëpo duke u thirrur ne nenin 60 te LPP-se fillimisht tenderët duhet te vlerësohen nga ana administrative se a janë te përgjegjshëm dhe ne pajtim me kërkesat e dosjes se tenderit. Citoj nenin 60 te LPP-se.

1. Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar :

1.1 tenderin e <u>përgjegjshëm</u> me çmimin më të ulët;

- Për pretendimin ankimor lidhur me autorizimin ne si AK nuk ju kemi dërguar sqarime te dosjes se tenderit sepse sipas nenit 39 te RRUOP sqarime për autorizim mund te kërkohen vetëm ne rast kur kërkohet autorizimi origjinal por është dorëzuar autorizimi i skanuar, citoj:

Është kërkuar autorizimi origjinal por është dorëzuar autorizimi i skanuar	Mund te kërkohen informata sqaruese	66

Pra ne këtë rast ju nuk e keni dorëzuar ne ofertën tuaj autorizimin nga prodhuesi dhe nuk kemi pasur çka te sqarojmë sepse nuk ka dëshmi se ju keni autorizimin.

- Për pretendimin ankimor lidhur me mostrën ju njoftojmë se mostra e ofruar nuk plotëson kërkesat e AK "Trafiku Urban", përkatësisht mostra e ofruara nuk është ne pajtim me kërkesat e parashtruara nga AK/njësia kërkuese si ne aneks 1 specifikimet teknike te detyrueshme. Ne specifikime teknike eshte kerkuar qe mostra ta kete logon, ndersa ju nuk e keni dorezuar mostren me logo.

Ne si AK jemi pajtuar plotësisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti Shqyrtues z. Muhadri deklaroj: Kërkesë e DT ka qenë Autorizim nga prodhuesi, OE ankues nuk ka autorizim fare, OE thirret ne nenin 39 të RrUOPP-së tek pjesa tabelore ku thotë është kërkuar Autorizimi origjinal por është dorëzuar i dorëzuar, mund te kërkohet informata sqaruese, ne rastin konkret ne DT OE ankues nuk ka ofruar autorizim. Pika tjetër është te aneksi 1 është kërkuar te ofrohet mostra e rollneve dhe ne mostër te jetë Logo e Trafikut Urban, duke u bazuar ne vendimin e kërkesës për rishqyrtim ku ne vendim e kanë qitur edhe pjesën e specifikimeve teknike OE mostrën e ka ofruar jo me Logo te Trafikut Urban ashtu siç është kërkuar, (është një logo tjetër).

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues qe ankesa jonë të aprovohet si e bazuar dhe lënda te kthehet në rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e AK-së deklaroj: Propozojmë te vazhdohet me dhënie të kontratës dhe të hedhet poshtë ankesa e OE ankues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues profesional , deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se arsyeje e eliminimit të OE "MEDIATECH & PRINT" SHPK, sipas

autoritetit kontraktues është citat: "Në ofertën tuaj nuk keni plotësuar kërkesat mbi mundësit teknike dhe ose profesionale, saktësisht nuk keni ofruar e Autorizimit nga punëdhënësi ose distributori të autorizuar për shitjen e letrës termike (rollneve), si dhe mostrat e ofruara nuk plotësojnë kërkesat e AK-Trafiku Urban".

Paneli shqyrtues konform eksperti shqyrtues profesional konstaton se në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit është kërkuar: "Operatori ekonomik duhet në ofertën e tije të prezantoj kopjen e Autorizimit nga Prodhuesi ose distributori të autorizuar për shitjen e letrës termike (rollneve). Nga fituesi relevant do të kërkohet sjellja në origjinal e autorizimit të prezantuar para shpalljes se vendimit të AK".
Andaj pas analizimit dhe sqarimit të dosjes së tenderit si dhe pretendimeve ankimore, konstatojmë se OE ankues "MEDIATECH & PRINT" SHPK, nuk e ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, pra nuk ka ofruar autorizim nga prodhuesi e as nga distributori i autorizuar për shitjen e letrës termike (rollnev).

Sa i përket pretendimit të OE ankues "MEDIATECH & PRINT" SHPK, ku pretendon se AK, konform nenit 39.8 të RrUOPP-së, ka qenë i obliguar të kërkoj sqarime shtesë, Paneli shqyrtues konform eksperti shqyrtues profesional konstatonse tek neni 39.8 i RrUOPP-së, konkretisht tek pjesa tabelore sqarohet qartë:Është kërkuar autorizimi origjinal por është dorëzuar autorizimi i skanuar; Mund te kërkohen informata sqaruese; 66.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se në këtë aktivitet të prokurimit kemi tre 3 autorizime të njëjta, duke pretenduar se autorizim jepet vetëm për një distributor dhe vetëm një OE mundet të konkurroj me atë autorizim edhe ky fakt është shumë kontradiktor, pasi edhe me dispozita ligjore vetëm një autorizues e ka autorizimin nga distributori.

Paneli shqyrtues konform eksperti shqyrtues profesional konstaton se operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit NTP "VLORA", "INFINITT" SHPK dhe NTG "BLENDI", e kanë autorizimin nga NT "FIRST POINT", përfaqësuar nga Astrit Martinaj – drejtor, andaj askund as një dispozitë e LPP-së dhe RrUOPP-së, nuk e ndalojnë dhënien e autorizimit nga Distributori dy e më shumë OE.

Operatori ekonomik ankues "MEDIATECH & PRINT" SHPK, deklaron: Po ashtu qe kemi vërejtur se kompania e shpallur fituese në këtë aktivitet të prokurimit është me pronar e drejtor të njëjtë sikur OE i renditur i pari në procesverbalin e hapjes.

Paneli shqyrtues konform eksperti shqyrtues profesional konstaton se pas analizimit të pretendimit ankimor të OE ankues si dhe pas analizimit të ofertave të OE NTP "VLORA" dhe "INFINITT" SHPK, pronar dhe person i autorizuar në certifikatën e biznesit te OE NTP "VLORA", është z. Adnan Krasniqi, ndërsa tek certifikata e biznesit të OE "INFINITT" SHPK, pronar dhe person i autorizuar është znj. Selvie Krasniqi, pra këtu kemi të bëjmë me pronar të ndryshëm.

Paneli shqyrtues konform eksperti shqyrtues profesional konstaton se në dosjen e tenderit tek Aneksi 1 i dosjes (specifikimet teknike te detyrueshme) është kërkuar:

Letra termike (rollne) sasia 36000 copë me specifikime teknike:
- Garancioni i letrës pesë (5) vite (qëndrueshmëria e shënimeve në letër 5 vite);
- Gjatësia e rrollneve 58 mm gjatësia 30 m;
- Shtypja e logos në pjesën e pasme me ngjyrë;
- Dy (2) metrat e fundit rollnet duhet të jenë të vijëzuara me ngjyrë të kuqe si dëshmi se rrojllnja është shpenzua;
- Letra termike duhet të jetë sikur mostra më poshtë në foto e cila mund të shikohet edhe në formë fizike tek hapësirat e AK-së.

Vëmendje

1. Tenderuesi me ofertën të dorëzoj edhe një mostër para hapjes së ofertave për krahasim me mostrën e AK-së;
2. Tenderuesi duhet të ketë autorizimin nga prodhuesi ose të jetë distributor i autorizuar;

Andaj në bazë të vendimit mi refuzimin e kërkesës së shqyrtimit, OE ankues nuk e ka ofruar letrën termike (rollnen) me Shtypje të logos në pjesën e pasme me ngjyrë, dhe kjo mund të vërtetohet me mostrat të cilat është i obliguar ti ofroj AK-së, gjatë shqyrtimit kryesor.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Autoriteti kontraktues gjatë vlerësimit të ofertave i është përmbajtur në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi Paçarizi

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK –N.P.K."TRAFIKU URBAN"SH.A- Prishtinë,

1x1 OE–"MEDIATECH & PRINT"SH.P.K – Prishtinë,

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.